

## **Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve**

**1.** Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre:

- a) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak;
- b) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

**2.** Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit.

**3.** Përcaktimet e sipërpërmendura nuk anashkalojnë afatet kohore të përcaktuara në ligje të veçanta për procedurat e konsultimit dhe informimit publik.